

VAZHDIMI I SHKOLLIMIT SEKSI DHE LIDHJET PRINDËRIT U NDIHMOJNË TË RINJVE TË RUHEN, TË JENË TË LUMTUR DHE TË MËSOJNË



KËSHILLAT KRYESORE

- **Theksojini anët pozitive** Në të shumtën e rasteve fëmijët do të merakosen që nuk do të mund të krijojnë miqësi të reja në shkollë të mesme ose që do të keqtrajtohen. Tregojuni që sipas hulumtimeve shumica e fëmijëve vërtetë kënaqen kur vijnë në shkollë të mesme dhe që lidhin miqësi të reja.
- **Flisni me fëmijët për ndryshimet në jetën tuaj** Tregojini se si e keni ndjerë veten gjatë ndryshimeve të vona, si për shembull kur keni filluar punën e re. Shumë probleme do të jenë të ngjashme.
- **Flisni për ndërrimet gjatë pubertetit** Prindërit shpesh kanë turp të flasin me fëmijët për zhvillimin e trupit të tyre. Mirëpo ne e dimë që fëmijët kanë dëshirë të flasin me prindërit e tyre për këto ndërrime. Pse të mos shfrytëzoni skena nga serialet ose filmat? Flisni për kujtimet tuaja të pubertetit nëse s'e keni të vështirë.
- **Shumica e të rinjve nuk bëjnë seks para moshës 16 vjeçe** por shumë fëmijë, të rinj dhe prindër mendojnë kështu. Përmendeni mundësinë që ka mundësi që shokët e tyre vetëm bëjnë sikur kanë pasur seks, dhe ndihmohuni ta kuptojnë që ata mund të jetojnë krye më vete. Diskutimet e hapura do t'i ndihmojnë fëmijës suaj që t'i mendojë gjërat deri në fund dhe do t'ua dhurojnë vetëbesimin që t'u rezistojnë trysnive.
- **Merreni vesh se çfarë mësimesh merr fëmija juaj** Të gjitha shkollat duhet ta kenë të shtypur në letër linjën e veprimtimit sa i përket asaj që mësohet për seksin dhe për lidhjet – kërkojeni një kopje për vete.
- **Disa prindër merakosen që edukimi seksual në shkollë** i nxit të rinjtë që të bëjnë seks më herët. Nuk ka asnjë dëshmi që kjo është e vërtetë, por ka shumë dëshmi që SRE u ndihmon të rinjve që të jenë më të vetëdijshëm për rreziqet dhe për të zgjedhur mundësitë më të sigurta të mundshme.
- **Informohuni më hollësisht për pubertetin, seksin dhe lidhjet** Ekzistojnë shumë organizata që ofrojnë informacione të mira për prindërit dhe për fëmijët e moshave të ndryshme – disa prej tyre janë të shënuara në fund të kësaj fletushke. Nëse ju vjen vështirë të flisni me fëmijën tuaj lidhur me ndonjë gjë, mund t'ua lëni fletushkat dhe informacionet diku ku ata do t'i gjejnë.

LIDHJET MES FËMIJËVE DHE TË RINJVE

- Në shkollë fillore, shumica e fëmijëve e kalojnë kohën e vet në shoqëri të gjinisë së njëjtë. Kjo vazhdon edhe gjatë vitit të parë ose edhe të dytë të shkollës së mesme. Mirëpo rreth moshës 13 ose 14 vjeçe, shumica e të rinjve fillojnë që të shoqërohen në grupe të gjinive të përziera.
- Gjatë vitit të fundit të shkollës fillore, fëmijët mund të zhvillojnë shoqëri shumë të ngushta. Fëmijët mund ta kenë të vështirë nëse shokët e tyre shkojnë në shkollë të mesme të ndryshme. Fëmijët do të kenë nevojë që t'i bindë dikush që ata do të gjejnë shokë e shoqe edhe në shkollën e tyre të re dhe t'iu ndihmojë dikush që t'i ruajnë kontaktet me shokët e tyre nga shkolla fillore.
- Disa fëmijë do të kenë vetëm disa shokë ose s'do të kenë fare. Shumë prej tyre nuk e kanë problem këtë gjë – ata janë të lumtur që kohën ta kalojnë vetëm ose me familjet e tyre. Por, ka edhe fëmijë të cilëve u mungon shkathtësia sociale ose vetëbesimi për të zhvilluar marrëdhënie me fëmijë të tjerë. Nëse ju merakos kjo gjë, flisni me

shkollën e fëmijës suaj ose me cilëndo nga organizatat e shënuara në fund të kësaj fletushke.

ZHVILLIMI TRUPOR DHE SEKSUALITETI GJATË ADOLESHENCËS

- Fëmijët fillojnë të pyesin për seksin dhe për lidhjet qysh në moshë të hershme. Ata duan të mësojnë se si funksionojnë gjërat.
- Shumë ndryshime gjatë pubertetit siç është vrulli i rritjes fillojnë derisa fëmijët ndjekin shkollën fillore.
- Puberteti paraqitet në shkallë të ndryshme te njerëzit e ndryshëm. Disa prej ndryshimeve mund të fillojnë të paraqiten madje edhe në moshën 8 ose 9-vjeçare, ndërsa te ndokush tjetër tek në moshën 14 ose 15-vjeçare. Zakonisht vajzat e fillojnë dhe e përfundojnë pubertetin diku dy vite më herët se djemtë. Është mirë që ta bindni fëmijën tuaj që ai ose ajo nuk është jonormale vetëm pse të tjerët duken që piquen para tyre.
- Gjatë viteve të hershme të shkollës së mesme, shumë të rinj krijojnë lidhje të ngushta. Disa të rinj ndihen të tërhequr nga gjinia e kundërt, kurse disa nga gjinia e njëjtë. Shumë prej tyre nuk do ta kenë të qartë identitetin e vet seksual deri vonë.
- Shkalla e infektiveve seksualisht të transmetueshme (STI) te të rinjtë është në rritje. Kështu për shembull shkalla e klamidias në mesin e të rinjve është ngritur për 300% gjatë dhjetë viteve të fundit. Të rinjtë që kanë bërë seks para moshës 16 vjeç kanë më shumë gjasë që të pendohen sesa ata që fillojnë më vonë, dhe më pak gjasë që të përdorin mjete për pengim të shtatzënisë.
- Shumë të rinj janë të keqinformuar lidhur me seksin dhe lidhjet. Për shembull shumë të rinj besojnë që femra nuk mund të mbesë shtatzënë herën e parë që bën seks. Kjo s'është e vërtetë. Shkalla e shtatzënieve gjatë adoleshencës është në rënie, mirëpo shumica e shtatzënieve të hershme janë të paplanifikuara. SRE-ja dhe diskutimet e hapura me prindërit u ndihmojnë të rinjve që të marrin vendime të sigurta dhe të informuara.

PSHE DHE SRE NË SHKOLLA

- Të gjitha shkollat e mesme japin mësim për disa aspekte të lidhjeve personale, ndryshimeve gjatë pubertetit si dhe seksit dhe seksualitetit. Disa shkolla e bëjnë këtë në kuadër të Edukimit Personal, Social dhe Shëndetësor (PSHE) ose nëpërmjet Edukimit mbi seksin dhe lidhjet (SRE).
- Planprogrami Mësimor Kombëtar për shkencë parasheh që nxënësit duhet të mësohen për riprodhimin njerëzor dhe për përhapjen e sëmundjeve. Prindërit kanë të drejtë që t'i nxjerrin fëmijët e tyre nga orët e SRE-së, por fëmijët duhet t'i ndjekin orët në kuadër të planprogramit të shkencës.
- SRE-ja në shkolla mbron fëmijët dhe të rinjtë – ajo **nuk** i nxit ata që të bëjnë seks.

BISEDA ME TË RINJTË LIDHUR ME SEKSIN DHE LIDHJET

- Shumica e të rinjve thonë që do të dëshironin të flisnin me prindërit e tyre për çështjet e lidhjeve dashurore dhe të seksit. Ekzistojnë dëshmi që në vendet e tjera ku fëmijët, të rinjtë dhe prindërit janë të sinqertë rreth këtyre çështjeve, të rinjtë presin më gjatë

derisa ta provojnë seksin. Gjithashtu gjasa është më e madhe që kur të bëjnë seks, ata të përdorin mjete për pengimin e shtatzënisë.

- Në të shumtën e rasteve, prindërit ndihen keq kur duhet të flasin për seksin dhe lidhjet dashurore. Ata deklarojnë që u vjen turp, që fëmijët dhe të rinjtë dinë më shumë se ata rreth disa prej temave dhe që biseda për seksin mund t'i nxisë të rinjtë që ta eksperimentojnë atë.
- Shumicën e informatava rreth seksit dhe lidhjeve dashurore të rinjtë i marrin nga shokët, shkolla dhe nga revistat.
- Shumë prindër thonë që serialet dhe filmat mund të ndihmojnë hapjen e diskutimeve lidhur me lidhjet dashurore, seksin dhe seksualitetin.
- Diskutimi i hapur në shtëpi i mbron fëmijët dhe të rinjtë – ai **nuk** i nxit ata që të bëjnë seks herët.

Për informata dhe këshilla të mëtejme:

FPA (planifikimi familjar) – 0845 310 1344 www.fpa.org.uk
ofrojnë një sërë materialesh lidhur me seksin dhe lidhjet dashurore, për të rinjtë dhe prindërit.

Brook – 020 7284 6040 www.brook.org.uk

FFLAG (Familjet dhe Shokët e Lezbikeve dhe Homoseksualëve) – 01454 852418
www.fflag.org.uk

E-maili: info@fflag.org.uk

Organizatë gjithëkombëtare që mbështetë prindërit e fëmijëve homoseksualë dhe biseksualë.
www.connexions.com u kushtohet të rinjve por përmban informata të shumta të dobishme edhe për prindërit

Parentline Plus – DfES e mbështetë fushatën Koha për të Biseduar [Time to Talk] për t'u ndihmuar prindërve që të flasin me fëmijët e tyre mbi lidhjet dashurore dhe mbi seksin. Prindërit mund të këshillohen në telefonin kujdestar ose të shkarkojnë materiale informative nga website-i.

Telefoni kujdestar 0808 800 22 22

www.parentlineplus.org.uk

Ruthinking – Për 13-18-vjeçarët: informacione, këshilla dhe shoqëruet për lidhjet dashurore, seksin dhe mjetet për pengim të shtatzënisë

Telefoni kujdestar 0800 28 29 30

www.ruthinking.co.uk

Ju lutemi shënojinë në vazhdim njoftimet lokale dhe mundësitë e kontaktimit